



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.11.2023, ora 8:45 (online)

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim nen për nen i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Antoneta Dhima, Bardhyl Kollçaku, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Denis Deliu, Luan Duzha, Ilirian Pendavinji, Ferdinand Xhaferraj, Asllan Dogjani, Bujar Çela, Klevis Xhoxhi dhe Arkend Balla.

Mungojnë:

Agron Çela, Paulin Sterkaj, Lindita Metaliaj, Flamur Noka, Isuf Çelaj, Ervin Salianji, Enkelejd Alibeaj, Monika Kryemadhi dhe Lefter Gështenja.

Të ftuar:

Z. Taulant Balla- Minister i Brendshëm,

Z. Niko Peleshi -Ministër i Mbrojtjes

Z.Besmir Beja- Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Brendshme

Z. Viktor Hysaj- Drejtor i Buxhetit, në Ministrinë e Brendshme

Znj. Gelardina PRODANI Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes

Kol. Aleksandër PANDO Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH

Z. Nuri LAKNORI, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Mbrojtjes

Znj. Monika Plasa - Drejtore e Departamentit të Administrimit dhe Shërbimeve, Shërbimi Informativ i Shtetit

Romina Peci -Drejtoe e Drejtorisë Ekonomike dhe të Administrimit, Shërbimi Informativ i Shtetit

Z. Gentian Opre – Drejtor, Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Z. Fran Brahimi – Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Më dëgjoni? Zoti Peleshi! Zoti Balla!

Faleminderit!

Të nderuar kolegë, sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Të ftuar kemi zotin Taulant Balla, ministër i Brendshëm, së bashku me stafin.

Faleminderit, zoti Balla!

Kemi zotin Niko Peleshi, ministër i Mbrojtjes, së bashku me stafin.

Kemi zotin Besmir Beja, zotin Viktor Hysaj, zonjën Geraldina Prodani, zotin Aleksandër Panda.

Kemi përfaqësues nga Shërbimi Informativ Shtetëror zonjën Monika Plasa, drejtore e Departamentit të Administrimit dhe Shërbimeve dhe zonjën Romina Peçi, drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

Faleminderit! Më dëgjon?

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kemi zotin Gentian Opre dhe zotin Fran Ibrahim.

Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit “Për vitin 2024”, Komisioni për Sigurinë Kombëtare u fokusua më shumë në ato aspekte të buxhetit, të cilat trajtojnë elemente financiare në rendin publik dhe sigurinë e vendit, duke zhvilluar seanca dëgjimore me institucione si Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Megjithëse jemi në fazën e shqyrtimit nen për nen, ju ftoj që në raportin tonë që do të votojmë, të nderuar kolegë, të jemi pro marrjes në konsideratë të shtesave dhe rishpërndarjes së fondeve për secilin prej institucioneve sipas kërkesave të bëra prej tyre.

Më dëgjoni? Faleminderit!

Duke qenë se nuk ka asnjë amendament, nuk ka kërkesa të tjera dhe jemi vetëm në miratimin nen për nen, kush është dakord në parim me projektbuxhetin?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet në parim!

Kalojmë në miratimin nen për nen të buxhetit për vitin 2024.

Kush është dakord me nenin 1?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 2?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 3?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 4?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 5?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 6?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 7?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 8?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 9?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 10?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 11?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 12?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 13?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 14?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 15?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 16?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 17?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 18?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 19?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 20?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 21?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 22?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”.

Kush është dakord?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Faleminderit, të nderuar kolegë!

Faleminderit, të ftuar!

Janë marrë në konsideratë të gjitha propozimet tuaja dhe do të shoqërohen...

Po, zoti Peleshi!

Niko Peleshi – Ndjesë, se jeni në proces votimi, por në fakt ne e kemi sjellë kërkesën, gjë që e përmendëm edhe në komision, për një rishpërndarje të fondit të programit buxhetor të Emergjencave Civile, te neni 15, por nuk ndërhyja dot në proces votimi. Besoj se është marrë parasysh...

Nasip Naço – Po, po, është marrë parasysh, prandaj e thashë që në fillim: të gjitha propozimet janë marrë parasysh dhe janë në raportin që shoqëron buxhetin dhe do t'i shkojë komisionit përkatës.

Niko Peleshi – Ndërkohë kemi edhe diçka tjetër. E kuptoj që nuk është shumë normale, pasi jemi të vonuar, ndodhemi në procesin e votimit nen për nen, por te neni 15, ose diku tjetër, nëse është e mundur le të përfshihet një aneks për të hapur një hapësirë buxhetimi për projektet e rindërtimit të varrezave të Dëshmorëve të Atdheut. Në fakt, ne kemi një justifikim ose argument në lidhje me faktin që e kemi vonuar, sepse kemi qenë në komunikim me Ministrinë e Kulturës për të zgjidhur çështjen: a janë monument kulture apo s'janë monument kulture, kush ka të drejtë të ndërhyjë, a mundet ministria të mbështesë bashkitë me një fond për rikonstruksionin apo restaurimin e ndërtesave? Them se kemi arritur një dakordësi në parim, le të themi verbalisht me Ministrinë e Kulturës, dhe do ta zgjidhim shpejt çështjen, por na duhet të hapim një dritare, një aneks për t'i financuar. Pra, ideja është që një pjesë të buxhetit nga Ministria e Mbrojtjes, njëlloj si me modelin e projekteve të mbështetjes për Mbrojtjen Civile, hapim thirrjen. Bashkitë që kanë nevojë për rikonstruksion varrezash apo për ndërtim varrezash të reja, në ndonjë rast, aplikojnë me projekte. Bashkitë fituese, pesë, gjashtë apo shtatë, me sa buxhet të kemi, marrin nga ne si transfertë fondin e kushtëzuar për investim, dhe realizojnë investimin njëlloj si projektet e investimeve. Ne mendojmë të çelim një fond prej rreth 200 milionë lekësh, meqenëse vitin tjetër kemi edhe tetëdhjetëvjetorin e çlirimit të vendit. Nuk e di nëse mund të akomodohet.

Nasip Naço – Dakord, zoti Peleshi, mund të na i paraqisni me shkrim brenda ditës së sotme.

Niko Peleshi – Patjetër!

Nasip Naço – Ne jemi duke përfunduar raportin pas kësaj dëgjese, për t’ia dërguar komisionit përkatës. Besoj se edhe kolegët janë dakord, që bashkë me propozimin tuaj t’i dërgohet komisionit përkatës.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit! Ndjesë edhe një herë!

Nasip Naço – Faleminderit edhe juve për ndërhyrjen, zoti Ministër!

Të nderuar kolegë, nëse s’keni ndonjë gjë tjetër, ju falënderoj.

Jemi të gjithë dakord. Faleminderit!

Faleminderit, zoti Balla!

Faleminderit, zoti Peleshi!

Faleminderit, përfaqësuesve të Shërbimit Informativ Shtetëror!

Ju faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA